

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                           |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | SHBA-ja synon ta kthejë marrëveshjen e transitit Armeni-Azerbajxhan në mundësi investimi                  |
| ADRESA  | https://dosja.al/bota/shba-ja-synon-ta-ktheje-marreveshjen-e-transitit-armeni-azerbajxhan-ne-mund-i516059 |
| BURIMI  | dosja.al                                                                                                  |
| GJENDJA | online                                                                                                    |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 25 shtator 2026, 19:01:43 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 18:50:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 9fa5a4a31d860f1702ba9af37a79bb830889c8228598aa324a1c6485d80246e4 |
| TEKSTI     | 21ba191b415cfa2fb9f93999abbb6ee9220f8f2b903ab5b29f4edae708236043 |
| PAMJA      | c02dfdc0383bc24c7857c2304f09d5d542e3114f6c60f7a3b4cf37c1076a0076 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 9d209c359968829c5bb318cb5b781f09aa6bacd9592849a44d53893a0f78a436                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 9fd2d6c8eaed582dbfbd973ad421bf483fa1abd0a548cdf1a11aa95128494a7b                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9d209c359968829c5bb318cb5b781f09aa6bacd9592849a44d53893a0f78a436>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





LIVE UPDATES

20 MINUTA ME PARE

"Shqipëria po përjeton të ardhmen që të tjerët ende po e diskutojnë"/ Rama nga OKB: Algoritmi aktivizoi urrejtjen, qytetarët protestuan kundër një armiku fantazmë

2 ORE ME PARE

Dita e 118-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

3 ORE ME PARE

"Shqipëria e shqiptarëve është slogan i neveritshëm dhe i turpshëm"/ Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës

5 ORE ME PARE

Konflikt në Durrës/ Shefi i Policisë së Krujës përplaslet fizikisht me pronarin e ish-hotelit "Mira Mare": Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava

Bota

## SHBA-ja synon ta kthejë marrëveshjen e transitit Armeni-Azerbajxhan në mundësi investimi

Sfida tani është shndërrimi i një marrëveshjeje politike në çelik, asfalt dhe investime.

dosja 25 Shtator 2026, 20:50  
Nga E.d



Jeyhun Bayramov dhe Ararat Mirzoyan

Administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, po përpiqet ta shndërrojë hapjen, që ka ndërmjetësuar mes Armenisë dhe Azerbajxhanit, në diçka më konkrete: një korridor transporti që lidh Azinë Qendrore dhe Kaukazin Jugor me tregjet perëndimore, si dhe një mundësi investimi për kompanitë amerikane.

Zyrtarë të lartë rajonale dhe drejtues të më shumë se 40 kompanive u mbledhën në Nju Jork më 23 shtator për të diskutuar hapat e ardhshëm për Rrugën Trump për Paqen Ndërkombëtare dhe Prosperitetin (TRIPP), një nga shtyllat kryesore të përpjekjeve të Uashingtonit për ta shndërruar hapjen mes Armenisë dhe Azerbajxhanit në rritje të tregtisë dhe investimeve rajonale.

Në këtë ngjarje, që u mbajt në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, morën pjesë i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara, Steve Witkoff, dhe senatori republikan nga Montana, Steve Daines, si dhe zyrtarë nga Armenia, Azerbajxhani, Gjeorgjia dhe pesë shtetet e Azisë Qendrore.

Sfida tani është shndërrimi i një marrëveshjeje politike në çelik, asfalt dhe investime. Nuk ka nisur ende asnjë ndërtim, studimet e fizibilitetit janë ende duke u zhvilluar dhe kompanitë nuk pritët të fillojnë të konkurrojnë për kontratat e mëdha deri në fund të vitit 2026 ose në fillim të vitit 2027.

Uashingtoni e sheh TRIPP-in si një korridor multimodal përmes jugut të Armenisë, që lidh Azerbajxhanin me enklavën e tij Nakçıvan dhe krijon një lidhje më të gjerë lindje-perëndim mes Kaukazit Jugor, Azisë Qendrore dhe tregjeve perëndimore.

Seksioni i propozuar armen është vetëm rreth 43 kilometra i gjatë, por synon që të zgjidhë një nga çështjet më të debatueshme që ka dalë nga konflikti prej dekadash mes Armenisë dhe Azerbajxhanit: si të lidhet Azerbajxhani me Nakçıvanin përmes territorit armen.

### editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

### Në vëmendje

INSIGHTS 25 SHTATOR 2026, 20:57

Kur të bie Diella në kokë

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

"Të q\*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë

Armenia dhe Azerbajxhani zhvilluan dy luftëra të mëdha për Nagorno-Karabakun, që ndërkombëtarisht njihet si territor i Azerbajxhanit, që për dekada kishte një popullsi kryesisht etnike armene. Azerbajxhani rivendosi kontrollin e plotë mbi territorin në vitin 2023, duke bërë që pothuajse e gjithë popullsia e tij etnike armene të largohej.

Të dyja vendet ranë dakord për tekstin e një traktati paqeje në mars të vitit 2025, por ende nuk e kanë përmbyllur marrëveshjen përfundimtare. Në një samit në Shtëpinë e Bardhë, pesë muaj më vonë, kryeministri armen, Nikol Pashinian, dhe presidenti i Azerbajxhanit, Ilham Aliyev, nënshkruan një deklaratë të përbashkët, të ndërmjetësuar nga SHBA-ja, që synon t'i japë fund konfliktit prej dekadash dhe të hapë lidhjet e transportit në rajon. TRIPP-i doli nga kjo marrëveshje.

TRIPP-i synon që të mundësojë transit të papenguar mes pjesës kontinentale të Azerbajxhanit dhe Nakçivanit përmes territorit armen, duke ruajtur sovranitetin, integritetin territorial dhe juridiksionin e Armenisë – një dispozitë politikisht e rëndësishme, duke pasur parasysh mosmarrëveshjet e gjata rreth kontrollit të rugës.

Projekti është paraparë që të zhvillohet nga një kompani amerikano-armene, në të cilën Shtetet e Bashkuara synohet që të kenë kontroll, duke i dhënë Uashingtonit një rol të rëndësishëm në një rajon strategjik ku Rusia tradicionalisht ka ushtruar ndikim të konsiderueshëm.

Sipas planit, seksioni armen në fund do të përfshijë lidhje hekurudhore dhe rugore, si dhe infrastrukturë energjetike dhe digjitale.

#### Nga marrëveshja e paqes te rruga tregtare

Witkoff u dha merita Pashinianit dhe Aliyevit për njohjen e faktit se një marrëveshje paqeje ofronte një alternativë më të mirë ndaj konfliktit prej dekadash.

"Ndryshe nga shumë konflikte të tjera që shohim në botë, këtu i kishim të gjithë përbërësit për një marrëveshje", tha Witkoff, duke i përshkruar dy udhëheqësit si "jashtëzakonisht pragmatikë dhe të pjekur".

Ai gjithashtu i dha merita presidenti Trump për shtyrjen përpara të procesit, pasi zyrtarët amerikanë konstatuan se komunikimi mes Jerevanit dhe Bakusë kishte ngecur.

Megjithatë, fokusi në Nju Jork ishte nëse hapja diplomatike tani mund të sjellë përfitime ekonomike.

Witkoff tha se implikimet ekonomike të TRIPP-it po bëhen gjithnjë e më të dukshme, teksa zyrtarët dhe kompanitë shqyrtojnë potencialin që ka projekti për të luajtur në zinxhirët ndërkombëtarë të furnizimit.

"Gjithçka tani është përqendruar te transmetimi dhe shpejtësia e arritjes në treg", tha ai, duke iu referuar vlerësimeve se rruga mund të shkurtojë disa udhëtime tregtare deri në tri javë.

TRIPP-i mund të integrohet në Korridorin Transkaspik, ose Korridorin e Mesëm, një rrjet lindje-perëndim përmes së cilit transportohen mallra mes Kinës dhe Azisë Qendrore përmes Detit Kaspik, Kaukazit Jugor dhe më tej drejt Evropës. Ky korridor ka tërhequr vëmendje të madhe, teksa qeveritë dhe bizneset kërkojnë alternativa ndaj rrugëve tradicionale të transimit përmes Rusisë.

Witkoff tha se pret që projekti të gjenerojë "investime të mëdha", veçanërisht në Armeni.

Duke folur në një ngjarje tjetër në Nju Jork më 23 shtator, Pashinian tha se zbatimi i TRIPP-it do ta "zhbllokojë plotësisht" ndërlidhjen rajonale dhe do të "hapë një epokë të re" për Armeninë dhe ekonominë e saj.

Megjithatë, për momentin, korridori mbetet kryesisht një projekt në letër.

Departamenti amerikan i Shtetit thotë se studimet inxhinierike dhe të fizibilitetit po shqyrtojnë rrugën e propozuar hekurudhore, përfshirë aspektet teknike, mjedisore dhe sociale. Një studim i ndarë i kryer më herë i fizibilitetit po shqyrton mundësinë e vendosjes së infrastrukturës energjetike dhe digjitale përgjatë lidhjeve të transportit.

Zyrtarët presin që puna për fizibilitetin e hekurudhës të përfundojë deri në fund të vitit 2026 ose në fillim të vitit 2027, pas së cilës kompanitë mund të konkurrojnë për kontratat. Ndërtimi i hekurudhës do të kërkonte të paktën 18 muaj të tjerë, ndërsa lidhjet e energjisë elektrike potencialisht mund të fillojnë të operojnë në vitin 2027.

#### Investimet amerikane

Uashingtoni po ndërton po ashtu struktura financiare dhe korporative që synojnë t'i shndërrojnë këto plane në projekte ku mund të investohet.

SHBA-ja dhe Armenia po krijojnë një kompani për zhvillimin e TRIPP-it, një ndërmarrje të përbashkët në të cilën Uashingtoni pritet të ketë shumicën e aksioneve dhe e cila do të mbikëqyrë zhvillimin e infrastrukturës dhe tenderët konkurrues.

njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

## më të klikuarat

"Te q\*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krugës shan qytetarin, ai zbrit nga makina dhe e qëllon me shpallë (VIDEO)



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

VIDEO/ Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për t'u shpëtuar plumbave, autorët e ndjekin dhe qëllojnë në mes të rrugës

"Europa nuk ka arritur ta zbatojë"/ Rama nga SHBA: Paqja kusht politik që zhvillimi ekonomik e bën të mundur

## insights

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gaganj

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

## Moti

Powered by tomorrow

Një Fond i Ndërmarrjeve Transkaspikë, i veçantë, synon të mobilizojë kapitalin privat për projektet e ndërlidhjes në mbarë rajonin.

Andrew D'Anieri, drejtor i Qendrës për Euroazinë në Këshillin e Atlantikut, tha se të dyja nismat sinjalizojnë angazhim më të thellë ekonomik të SHBA-së.

"Shtyrja përpara e projektit të TRIPP-it dhe njoftimi për Fondin e Ndërmarrjeve Transkaspikë në prani të zyrtarëve të lartë rajonalë dhe kompanive të mëdha amerikane dërgon një sinjal të fortë se Amerika e ka seriozisht", tha D'Anieri për Radion Evropa e Lirë.

"TRIPP-i do të përparojë më ngadalë, duke pasur parasysh shkallën e vështirësisë teknike të projektit dhe ndjeshmërive gjeopolitike", tha ai.

#### Një rrugë e re përmes një rajoni me shumë interesa

Këto ndjeshmëri shtrihen përtej Armenisë dhe Azerbajxhanit. Kaukazi Jugor lidh Evropën me Azinë Qendrore në një rajon ku Rusia, Kina, Irani dhe Turqia kanë të gjitha interesa të rëndësishme.

Angela Howard, hulumtuese në Qendrën për Fuqinë Ekonomike dhe Financiare të Fondacionit për Mbrojtjen e Demokracive, tha se infrastruktura e mbështetur nga SHBA-ja mund të krijojë lidhje të reja tregtare, teksa zvogëlon varësinë nga rrugët e kontrolluara ose të ndikuara nga Rusia.

"Investimi i SHBA-së në Kaukaz e vendos Amerikën në portën hyrëse për në Azinë Qendrore", tha ajo për Radion Evropa e Lirë.

Megjithatë, ajo paralajmëroi se projektet e mbështetura nga SHBA-ja do të kërkonin masa mbrojtëse kundër korrupsionit dhe ndikimit të huaj.

"Rregulla të forta mbrojtëse dhe mbikëqyrje e gjerë do të jenë kritike në të ardhmen", tha Howard.

Daines tha se Uashingtoni duhet ta vazhdojë angazhimin e tij dhe argumentoi se rajoni duhet të shihet jo vetëm përmes prizmit të konflikteve të së kaluarës, por edhe si një qendër e mundshme për tregti dhe investime.

Për momentin, kuadri politik ekziston, por studimet inxhinierike, financimi, tenderët dhe ndërtimi janë ende çështje që presin të realizohen në të ardhmen. Siç u shpreh një zyrtar i lartë amerikan, "ende nuk kemi arritur në atë fazë"./REL

jeyhun bayramov

ararat mirzoyan

shba

## Sondazh

Poll



25 Shtator 2026, 17:45

## VIDEO/ Rritja e çmimit të karburantit ndez protestat në Portugali, 500 kamionë dalin në rrugë

Pamje PORTUGALI- Rritja e çmimeve të karburantit ka nxitur protesta në Portugali, ku rreth 500 kamionë kanë dalë në rr...

Kushtetuesja në Bosnje ndalon financimin për lobim lidhur me shkëputjen e Republikës Sërpska

Beta

25 Shtator 2026, 17:25

Mali i Zi vendos viza për shtetasit nga Rusia, Bjellorusia dhe Turqia

Beta

25 Shtator 2026, 14:52

Kapet një kontejner me 24 tonë mish të skaduar, ishte destinuar për "Apetit" në Kosovë

Beta

25 Shtator 2026, 14:29

Papa Leo XIV nis sot vizitën në Francë, pritët nga qindra mijëra besimtarë

Beta

25 Shtator 2026, 14:12

Beta

25 Shtator 2026, 14:09

## Vuçiç akuzon Nenad Rashiq: Po zbaton verbërisht urdhrat e Albin Kurtit

Aleksandar Vuçiç SERBI- Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, e ka akuzuar politikanin nga Kosova, Nenad Rashiq, se, si&...

**Nga Titanët e teknologjisë te “Kurthi i Thukididit” dhe dollia simbolike/ PRAPASKENAT e darkës Trump-Xi në Shtëpinë e Bardhë**

Nota

25 Shkator 2026, 10:20

**Ministri i Jashtëm iranian: I kemi paraqitur SHBA-së planin për rihapjen e Hormuzit**

Nota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.